

V E N D I M
Nr.7, datë 19.2.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto dhe Arbenka Lalica, më datat 17.11.1998 dhe 16.12.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.59/4 Akti që i përket :

KERKUES: LUDOVIK E MARIJE DEDA, të përfaqësuar nga avokat Gjergj Sauli, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR : ALBERT AKSHIJA, i përfaqësuar nga avokat Halil Kopani, me prokurë.

O B J E K T I :

Deklarimin e papajtueshmërisë me ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” të vendimit nr.878, datë 13.6.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit. Baza ligjore neni 27 paragrafi i parë dhe neni 38 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Kërkuesit në kërkesë dhe në notën verbale, kanë parashtruar këto shkaqe për deklarimin antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit:

- Kolegji Civil pranon në vendimin e tij një fakt jo real, sikur ne kërkuesit jemi fëmijët e motrës së gruas të trashëgimlënësit, ndërsa në të vërtetë jemi fëmijët e motrës së trashëgimlënësit. Kjo ngatërresë e qëllimshme na ka spostuar në trashëgimtarë të radhës së tretë, duke mohuar të drejtën e trashëgimisë e të pronësisë të mbrojtur nga neni 27 i dispozitave kryesore kushtetuese.

- Gjykata e Kasacionit nuk ka zhvilluar proces të rregullt ligjor për faktin se konkluzionet e saj për birësimin e Albert Akshisë dhe për mungesën e dokumentacionit të gjendjes civile nuk janë të vërteta. Regjistrat janë të plota në Gjirokastër për periudhën që pretendohet se është bërë birësimi dhe në to nuk figuron as birësimi dhe as birësuesit. Që Albert Akshia nuk ka qenë i birësuar e konfirmon edhe testamenti i Marije Kadaresë, në të cilin ajo shprehet se gjithë pasurinë ja le nipit të saj Albertit, pra jo djalit të saj, poqese do ta kishte të birësuar.

- Kolegji pranon padrejtësisht se dëshmitë e trashëgimisë janë në kundërshtim me ligjin. Sipas dekretit “Mbi trashëgiminë” të vitit 1954 me ndryshimet e mëvonshme sipas ligjit nr.3169, datë 26.10.1960, ne kërkuesit jemi trashëgimtarë ligjorë të Zef Kadares, sipas ligjit të kohës së çeljes së trashëgimisë, pra Kodit Civil të vitit 1929, pasi trashëgimlënësi ka vdekur në vitin 1945.

- Gjykata e Kasacionit në kundërshtim me nenin 189 të Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm që i korrespondon nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile, ka prishur të dy vendimet dhe e ka zgjidhur vetë çështjen duke rrëzuar padinë. Në këtë rast Kolegji ka shqyrtuar çështjen jashtë kërkesave të nenit 9 të ligjit “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, që është ekuivalent me nenin 472 të Kodit të Ri të Procedurës Civile, duke bërë vlerësimin e provave që nuk i lejohej dhe duke injoruar faktet e provat e administruara në gjykim. Në këtë aspekt, ky veprim e bën procesin jo të rregullt, në kuptim të nenit 38 të ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuesve dhe të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Mbi padinë e ngritur nga Ludovik e Marije Deda, me objekt detyrimin e të paditurit Albert Akshija që t'i njohë trashëgimtarë, gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr.5787, datë 11.9.1995 ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar Albert Akshinë që të njohë paditësit si trashëgimtarë në një shtëpi të ngritur në një truall prej 1282 m² dhe të përbërë prej gjashtë dhoma, kuzhinë e anekse të tjera.

Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.5727, datë 22.12.1995 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër të dy vendimeve të mësipërme ka paraqitur ankim para Gjykatës së Kasacionit i padituri Albert Akshija. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.878, datë 13.6.1996, duke u bazuar në nenin 189 të Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm dhe në nenin 9 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile", ka prishur të dy vendimet (si atë të shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë) dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur rrëzimin e padisë.

Gjykata Kushtetuese konkludon se të gjitha çështjet e parashtuara në kërkesën e palës kërkuese kanë rëndësinë e tyre, por në aspektin kushtetues rëndësi vendimtare paraqet pretendimi i ngritur në kërkesë që lidhet me procesin jo të rregullt ligjor. Duke patur parasysh përfundimet e pranuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë si dhe përfundimet në të cilat ka arritur kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, arrihet në konkluzionin se kërkesa duhet pranuar dhe se vendimi i kolegjit civil të kësaj Gjykate është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, prandaj dhe duhet shfuqizuar si antikushtetues për këto arsye:

Në bazë të nenit 7 të ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe në bazë të nenit 9 të Ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile", dispozita këto që kanë qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Kasacionit ka vetëm detyrën të shqyrtojë bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugë kundërshtimi. Pra, Gjykata e Kasacionit nuk shqyrton bazueshmërinë në fakt dhe në prova të vendimeve të ankimuara, por vetëm bazueshmërinë në ligj të tyre. Kjo është edhe arsyeja që në nenin 9 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992, janë përcaktuar në mënyrë të precizuar rastet apo shkaqet për të cilat mund të ankimohet vendimi në Gjykatën e Kasacionit. Po të shqyrtohet ankimi në të cilin kryesisht kundërshtohen faktet dhe provat në të cilat është mbështetur vendimi i gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, si dhe po të shqyrtohet vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit në të cilin përgjithësisht është bërë analizë provash si dhe pranohet ekzistenca ose mosekzistenca e rrethanave dhe fakteve të caktuara, arrin në përfundimin se ky kolegji ka shkelur një parim esencial të gjykimit kasacional. Lidhur ngushtësisht me sa u përmend më sipër, veprimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit që duke i prishur të dy vendimet e ankimuara e ka gjykuar çështjen në fakt dhe ka rrëzuar padinë e paditësit jo vetëm nuk gjen mbështetje në nenin 189 të Kodit të Procedurës Civile ku dhe është bazuar vendimi, por e bën procesin jo të rregullt ligjor, pasi është vepruar në kundërshtim me detyrën funksionale të Gjykatës së Kasacionit. Neni 189 i Kodit të Procedurës Civile që i korrespondon nenit 485 të Kodit të Ri të Procedurës Civile, nuk parashikon të drejtën e kolegjit civil që të prishë të dy vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen. Megjithatë kjo parregullsi mund të mos përbente shkak për një proces jo të rregullt ligjor, në rast se kolegji civil do të prishte të dy vendimet dhe ta zgjidhte vetë çështjen për shkak se vendimet do të ishin rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit. Në rastin konkret duke interpretuar provat e administruara në dy gjykimet, si dhe duke i vlerësuar ato në të kundërtën e vlerësimit që i kanë bërë gjykatat e të dy shkallëve, kolegji civil ka arritur në përfundime të ndryshme, në ndonjë rast edhe duke shtrembëruar realitetin e fakteve. Kështu kolegji civil, krejtësisht pa baza, i konsideron paditësat jo si fëmijë të motrës së trashëgimlënës, por si fëmijë të motrës së gruas së trashëgimlënës e për rrjedhojë nga trashpëgimtarë të radhës së parë që pretendojnë, spostohen në trashëgimtarë të radhës së tretë. Po kështu, ndërsa të dy gjykatat konkludojnë se dokumentat e gjendjes civile ekzistojnë dhe se birësimi i pretenduar nuk është bërë për faktin se nuk ka asnjë vendim gjyqësor apo akt të gjendjes civile të Gjirokastrës e Shkodrës ku të jetë regjistruar birësimi, kolegji civil pranon të kundërtën, që dokumentet e gjendjes civile nuk ekzistojnë dhe që ky birësim është bërë duke u bazuar në një aktinjoftimi të realizuar në gjykatën e Tiranës në vitin 1950, por edhe kjo e pakonfirmuar nga dokumentat e gjendjes civile. Në rrethana të tilla, ku si rezultat i vlerësimit të provave dhe i pranimi të fakteve në mënyrë të kundërt në raport me vendimet e gjykatave më të ulta, është arritur në përfundime krejt të ndryshme, Kolegji Civil i Gjykatës së

Kasacionit nuk mund ta mbante vetë çështjen për zgjidhje, duke rrëzuar padinë, por detyrimisht duhej ta kthente atë për rigjykim sipas rastit në gjykatën e rrethit apo të apelit. Pikërisht edhe në këtë aspekt Kolegji Civil ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 38 të ligjit të mëparshëm nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, gjë që e bën vendimin e tij antikushtetues.

Duke shfuqizuar vendimin nr.878, datë 13.6.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, mbetet pa iu dhënë zgjidhje ankimit të paraqitur pranë kësaj Gjykate nga i padituri Albert Akshija, kështu që i takon Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që të marrë në shqyrtim këtë ankim dhe në varësi të problemeve ligjore që rezultojnë nga çështja, apo të nevojës së marrjes së provave, të vendosë në lidhje me bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara, duke respektuar kërkesat për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.878, datë 13.06.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 19.2.1999

Nr.59/4 i regjistrimit themeltar
Nr.7 i vendimit